

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN

Nr.Br. 400-17217

Data/Datum 30.04.2020



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministriho Kultura, Umladine i Sporto	
Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref.Nr.	<u>1460/2020</u>
Data	<u>28/04/2020</u>
Datum	
Emri i Autorit	
Emri	
Signature	
PRISHTINE, PRISTINA / PRISHTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

DHE

KOMUNËS SË LIPJANIT

1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit (MB) është mbështetja financiare për projektin “Ndërtimi i Stadiumit të Qytetit në Lipjan” projekt ky që do të implementohet gjatë viteve 2020/2021/2022.

2. AUTORITETET

Qëllim i Memorandumi do të përmbushet nga:
2.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; dhe
2.2. Komuna e Lipjanit.
(në tekstin e mëtejshëm: Palët)

3. OBLIGIMET E PALËVE

3.1. OBLIGIMET E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT (më tutje MKRS)

MKRS-ja merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, si në vijim:

3.1.1. Investon mjetet financiare në vlerë prej 600,000.00 euro për projektin “Ndërtimi i Stadiumit të Qytetit në Lipjan”

3.1.2. MKRS-ja, mjetet financiare në vlerë prej 600,000.00 euro do ti investoj në tri vite, si në vijim:

3.1.2.1. 200,000.00 (dyqind mijë euro) do të shpenzohen gjatë vitit 2020;

3.1.2.2. 200,000.00 (dyqind mijë euro) do të shpenzohen gjatë vitit 2021;

3.1.2.3. 200,000.00 (dyqind mijë euro) do të shpenzohen gjatë vitit 2022;

3.1.3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me kërkesë të Komunës së Lipjanit, cakton një zyrtar si Organ Mbikëqyrës për monitorimin e kontratës me vendim përkatës për implementimin e projektit.

3.1.5. Në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit, kujdesën për implementimin e projektit.

3.2. OBLIGIMET E KOMUNËS SË LIPJANIT

Komuna e Lipjanit merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi, si në vijim:

3.2.1. Merr përsipër menaxhimin dhe zhvillimin e të gjithave procedurave të prokurimit, për zbatimin e këtij memorandumi dhe arritjes së qëllimit të tij;

3.2.2. Në bashkëpunim me MKRS-në kujdesen për implementimin e projektit në fjalë.

3.2.3. Komuna e Lipjanit obligohet të dorëzojë një kopje të projektit Kryesor me CD në MKRS-së.

3.2.4. Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me kompaninë kontraktuese obligohen që, më së largu deri më 20 nëntor të vitit 2020 të sjellin raportin me situacionet e punëve të realizuara për pagesë

në Ministrinë Kulturës, Rinisë dhe Sportit, konform Ligjit të Buxhetit për vitin 2020 dhe kjo duhet të vlejë pastaj edhe për vitet 2021 dhe 2022. Konform kësaj pike Komuna e Lipjanit duhet të dorëzoj dokumentacionin si në vijim:

3.2.4.1. Situacionin përkatës me faturë të aprovuar nga Organi Mbikëqyrës i caktuar nga komuna e Lipjanit me Vendim;

3.2.4.2. Raportin teknik nga Organi Mbikëqyrës me përshkrim të punimeve të realizuara sipas projektin përkatës;

3.2.4.3. Kontratën me operatorin ekonomik me paramasë dhe parallogari sipas kontraktimit të projektit kryesor;

3.2.4.4. Shkresën përcjellëse nga Kryetari i Komunës si nënshkrues i Memorandumit për procedim të pagesës në MKRS.

4. ZBATIMI

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit e përcjellin zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e obligimeve në mbarëvajtjen e punimeve, deri në momentin e realizimit të qëllimit.

5. MUNDËSIA E NDËRPRERJES SË MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT DHE RRETHANAT E PAPARASHIKUARA

5.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve.

5.2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhjeve të Fuqisë mbinatyrore – Vis major dhe rrethanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren.

6. AFATI I REALIZIMIT

Afati i realizimit të qëllimit të Memorandumit të Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda viteve 2020/2021/2022.

7. AMANDAMENTIMI

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshoj apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë MB, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në MB në të ardhmen, apo në një amendament të këtij MB-je, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

8. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRËVESHJEVE

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidh rastet e tilla.

9. KOPJET DHE GJUHËT E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

10. HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

Vlora DUMOSHI,

Ministre e Ministrisë së
Kulturës, Rinisë dhe Sportit



Imri AHMETI,

Kryetar i Komunës së Lipjanit



Nënshkruar më 23/06/2020
Prishtinë